



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 402 Prot.

Tiranë, më 11.06 2015

VENDIM Nr. 60 datë 04.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8, të datës 04.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Ekspeditë nënujore “Harta Arkeologjike Nënujore e Bregdetit Shqiptar në kuadër Mesdhetar”* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof Muzafer Korkuti dhe Dr. Adrian Anastasi,

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Ekspeditë nënujore “Harta Arkeologjike Nënujore e Bregdetit Shqiptar në kuadër Mesdhetar”* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof Muzafer Korkuti dhe Dr. Adrian Anastasi, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Vazhdimi i kërkimeve në brezin e thellësisë nga 0m deri në 20m dhe për pjesë të caktuara testimi do të shkojë deri në thellësinë 40m, në zonat e Kepit të Lagjit dhe Kepit të Rodonit.
- II. Periudhave kohore e kryerjes së kërkimeve do të jetë deri në dhjetor 2015.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO